

SHËNIME SHPJEGUESE

VITI 2019

Shoqëria "Adi Professional" SH.P.K, Tiranë

Nipt K22113002I

Hartimi i Pasqyrave Financiare është bërë duke u mbështetur në kërkesat e ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe në kërkesat e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Pasqyrat Financiare janë përpiluar në bazë të kostos fillestare në hyrje dhe në vazhdimësi me koston e amortizuar për aktivet afatgjata materiale, dhe me koston mesatare të ponderuar për inventarët. Parimi bazë për përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve është parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mbjajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të ligjit me metodën e inventarit periodik.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivitet:

Totali i aktiveve është pasqyruar në bilanc në vlerën 63,336,609 lekë. Krahasuar me periudhën paraardhëse aktivitet totale janë rritur me 6,992,168 lekë.

Aktivitet afatshkurtra janë në shumën 59,129,062 lekë dhe përbëhen nga:

- Mjetet monetare në vlerën 13,973,304 lekë, të cilat krahasuar me periudhën paraardhëse janë rritur me 10,306,683 lekë.
- Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në shumën 39,951,794 lekë. Ky zë përbëhet nga klientë në shumën 27,979,225 lekë, të drejta ndaj shtetit për TVSH dhe tatime të tjera 246,025 lekë, si edhe debitorë të tjerë 11,726,544 lekë.
- Inventarë mallra në 31.12.2019 në vlerën 4,966,369 lekë.
- Zëri i shpenzimeve të parapaguara (shpenzime për tu shpërndarë) 237,595 lekë, të cilat përbëhen nga shpenzime për tu shpërndarë nga vitet e kaluara.



1

Aktivet Afatgjata Materiale Neto në Bilanc paraqiten me shumën 4,207,547 lekë. Vlerësimi i tyre është bërë me kosto minus amortizim. Aktivet Afatgjata të blera gjatë vitit 2019 janë në shumën 24,208 lekë. Gjendja në çelje të vitit 2019 me vlerë fillestare 7,470,879 lekë, shtuar gjatë vitit me 24,208 lekë. Është llogaritur amortizimi i vitit 2019 brenda normave të lejuara nga legjislacioni fiskal në shumën 1,051,887 lekë. Amortizimi i akumuluar paraqitet në shumën 2,235,654 lekë më 31.12.2018, pakësuar 0 lekë, shtuar për 1,051,887 lekë në vitin 2019. Amortizimin progresiv më 31.12.2019 është në shumën 3,287,541 lekë. Vlera neto e aktiveve afatgjata materiale e pasqyruar në bilanc është 4,207,547 lekë, si diferencë e vlerës totale të aktiveve afatgjata materiale me vlerë fillestare më 31.12.2019 në shumën 7,495,088 lekë, me amortizimin e akumuluar të tyre në vlerën 3,287,541 lekë.

Detyrimet :

Detyrimet afatshkurtra në bilanc në 31.12.2019 janë paraqitur në shumën 33,535,258 lekë, në fillim të vitit gjendja e tyre ka qenë 33,271,581 lekë, janë rritur me 263,677 lekë. Detyrimet afatshkurtra përbëhen nga

-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në shumën 32,977,285 lekë, të cilat përbëhen nga të pagueshme ndaj furnitorëve për furnizimet e kryera 23,222,575 lekë, detyrimet ndaj punonjësve për paga dhe shpërblime 686,597 lekë, detyrim ndaj qiradhënësit 679,219 lekë dhe detyrime të tjera në shumën 8,388,894 lekë.

-Të pagueshme për detyrime tatimore në shumën 557,973 lekë, të cilat përbëhen nga detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 55,355 lekë, detyrimi për tatim fitimin 291,247 lekë, detyrimi për TVSH-në 194,567 lekë, detyrimi për tatimin në burim 10,304 lekë dhe detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale 6,500 lekë.

Kapitali dhe rezervat

Shuma e kapitalit dhe rezervave më 31.12.2019 është pasqyruar në shumën 29,801,351 lekë dhe krahasuar me periudhën paraardhëse është rritur me 6,728,491 lekë (kjo shumë perfaqëson fitimin neto të vitit 2019).

Kapitali aksioner më 31.12.2019 është 100,000 lekë, në të njëjtën vlerë ashtu si edhe vitin e kaluar.



Rezerva ligjore është në vlerën 28,000 lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar.

Shoqëria në vitin 2019 ka rezultuar me një fitim neto prej 6,728,491 lekë .

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve)

Kjo pasqyrë është përpiluar bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës së tyre.

Të ardhurat gjithsej janë në shumën 90,491,573 lekë dhe përbëhen nga të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit që operon shoqëria në vlerën 90,128,282 lekë dhe të ardhura të tjera 363,291 lekë.

Shpenzimet gjithsej për vitin 2019 janë në shumën 82,575,701 lekë.

Zëri lënda e parë dhe materiale të konsumueshme ka shumën 52,040,759 lekë.

Shpenzimet e personelit janë në shumën 2,898,123 lekë dhe përbëhen nga shpenzimet për pagat dhe shpërblimet e personelit në vlerën 2,480,639 lekë dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore në shumën 417,484 lekë

Në zërin shpenzime konsumi dhe amortizimi është pasqyruar amortizimi i aktiveve të shoqërisë, i cili është llogaritur duke rënduar shpenzimet e vitit ushtrimor brenda normave të lejuara në shumën 1,051,887 lekë.

Në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi janë pasqyruar shpenzime në shumën 26,584,932 lekë, ku përfshihen shpenzime qiraje 867,377 lekë, humbje nga përkthimet valutore 199,863 lekë, shpenzime për shërbimet bankare 264,573 lekë, shpenzime kontabiliteti 60,000 lekë, shpenzime për taksa dhe tarifa vendore e doganore 296,245 lekë, shërbime nga të tretët 22,490,090 lekë, si edhe shpenzime të tjera në shumën 2,406,784 lekë.

Në zërin Fitim/Humbja para tatimit është pasqyruar fitimi i vitit në shumën 7,915,872 lekë.

Tatimi mbi fitimin për vitin 2019 është 1,187,381 lekë.

Fitimi neto për vitin 2019 është 6,728,491 lekë.



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare është bërë sipas metodës indirekte dhe sipas kërkesave të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

✓ **Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit** është bërë sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

ADMINISTRATORI

Hokriyila Tarya
A. Shalva



Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		-	-	0	0
2	Ndertime		-		0	0
3	Makineri,paisje,vegla		1,120,538	24,208		1,144,746
4	Mjete transporti		4,968,203			4,968,203
5	Mobilje dhe pajisje zyre		1,201,397			1,201,397
6	Paisje Informatike		180,741			180,741
	TOTALI		7,470,879	24,208	-	7,495,087

Amortizimi A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		0	0		0
2	Ndertime					0
3	Makineri,paisje,vegla		370,980	154,753		525,733
4	Mjete transporti		1,303,184	733,004		2,036,188
5	Mobilje dhe pajisje zyre		476,634	144,953		621,587
6	Paisje Informatike		84,856	19,177		104,033
	TOTALI		2,235,654	1,051,887	0	3,287,541

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2019
1	Toka		0			0
2	Ndertime		0			0
3	Makineri,paisje,vegla		749,558	24,208	154,753	619,013
4	Mjete transporti		3,665,019	-	733,004	2,932,015
5	Mobilje dhe pajisje zyre		724,764	-	144,953	579,811
6	Paisje Informatike		95,885	-	19,177	76,708
	TOTALI		5,235,226	24,208	1,051,887	4,207,547

Administratori
ADRIATIK TARJA

